

VENDIM
Nr.560, datë 28.5.2009

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT
RRUGOR KALIMASH-MORINË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private për interes publik”, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Kalimash - Morinë.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 384 (treqind e tetëdhjetë e katër) m², tokë/truall, me vlerë 1 012 224 (një milion e dymbëdhjetë mijë e dyqind e njëzet e katër) lekë, objekte, me vlerë 25 095 402.91 (njëzet e pesë milionë e nëntëdhjetë e pesë mijë e katërqind e dy pikë nëntëdhjetë e një) lekë, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi 26 107 626.91 (njëzet e gjashtë milionë e njëqind e shtatë mijë e gjashtëqind e njëzet e gjashtë pikë nëntëdhjetë e një) lekë.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 361 000 (treqind e gjashtëdhjetë e një mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme të Rrugëve.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 26 107 626.91 (njëzet e gjashtë milionë e njëqind e shtatë mijë e gjashtëqind e njëzet e gjashtë pikë nëntëdhjetë e një) lekë, të përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave, në Bankën e Shqipërisë, “Fondi i shpronësimeve”.

6. Shpronësimi të fillojë më 30.5.2009 dhe të përfundojë më 30.8.2009.

7. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmim nga ZRPP”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve. Për objektet, pronarët përveç dokumentacionit të pronësisë duhet të paraqesin edhe dokumentacionin tekniko-ligjor.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të bëjë likuidimin e pronarëve brenda afateve të përcaktuara në pikën 6 të këtij vendimi, në bazë të dokumentacionit të pronësisë. Për objektet, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të bëjë likuidimin e pronarëve në bazë të dokumentacionit tekniko-ligjor.

9. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITJSHME E RRUGËVE
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN
NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “KALIMASH-MORINË”

Nr.	Pronari			ZZK	Nr. pas	Truall			Objekte Vlera/lekë	Totali lekë	Vendndodhja	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri			Sip.m ²	Çmimi m ²	Vlera lekë				
1	Xhem	Maksut	Cenaj	1819	83/3	384	2636	1012224	2948401	3960625	Gostil	Konfirmuar nga ZRPP
2	Haxhi	Avni	Matmuja	2912	304/2/34				4995454.77	4995454.77	Perbreg	Konfirmuar nga ZRPP
3	Tafil		Oruçi	1543	191/2				2697028.23	2697028.23	Lagjja Drinas	Konfirmuar nga ZRPP
4	Xhemali	Ajet	Brahaj	1543	193/12				2265619.09	2265619.09	Lagjja Drinas	Konfirmuar nga ZRPP
5	Ajet	Xhem	Brahaj	1543	193/4				2438762.63	2438762.63	Lagjja Drinas	Konfirmuar nga ZRPP
6	Hajdin	Dan	Istrefi	1543	192/2				362554.13	362554.13	Lagjja Drinas	Konfirmuar nga ZRPP
7	Sadik	Shuaip	Dulla	1543	192/8				2180377.31	2180377.31	Lagjja Drinas	Konfirmuar nga ZRPP
8	Han	Shuaip	Dulla	1543	192/3				2180377.31	2180377.31	Lagjja Drinas	Konfirmuar nga ZRPP
9	Fatmir	Shuaip	Dulla	1543	192/9				2198949.56	2198949.56	Lagjja Drinas	Konfirmuar nga ZRPP
10	Musa	Shuaip	Dulla	1543	192/4				2827878.88	2827878.88	Lagjja Drinas	Konfirmuar nga ZRPP
	TOTALI					384		1012224	25095402.91	26107626.91		

